



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KUVENDI**

*Komisioni i Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjeve*

**RELACION**

**Per dekretin e Presidentit te Republikes nr. 4181, date 23.03.2004**  
**“Per kthimin e ligjit nr. 9198, date 26.02.2004**  
**“Per nje shoqeri gjinore te barabarte”**

Komisioni i Cështjeve Kushtetuese dhe Ligjeve, ne mbledhjen e dates 11.05.2004 mori ne shqyrtim dekretin e Presidentit “Per kthimin e ligjit “Per nje shoqeri gjinore te barabarte”.

Komisioni u njoh me arsyet e kthimit te ligjit here per shqyrtim edhe nje te tij ne Kuvend te Presidentit te Republikes te cilat u paraqiten para komisionit nga keshilltari i tij juridik. Motivet kryesore te kthimit per rishqyrtim te ligjit ishin si me poshte:

- a) Neni 11 i ligjit “Per nje shoqeri gjinore te barabarte” vjen ne kundërshtim me nenin 60 te Kushtetutes pasi zgjeron fushen kushtetuese te veprimtarise se institucionit te Avokatit te Popullit;
- b) Nenet 12 dhe 13 te ligjit te mesiperm krijojne nje situatë konflikti me ligjin “Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Ministrave”;
- c) Neni 13 i ligjit, nepermjet krijimit te Komitetit Nderministror sjell nje fature financiare per te cilen nuk eshte marre paraprakisht mendimi i Keshillit te Ministrave.
- d) Dispozitat e ketij ligji ne pergjithesi kishin karakter deklarativ dhe ne raste te vecanta binin ndesh edhe me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Anetaret e Komisionit, pasi degjuan argumentat juridike respektive te kthimit te ligjit dhe mendimin e disa shoqatave jofitimpruese te cilin kishin ndihmuar me asistencë ne hartimin e ligjit, diskutuan ne lidhje me dekretin e Presidentit te Republikes dhe arriten ne keto perfundime:

1. Lidhur me ceshtjen e ngritur ne dekretin e Presidentit te Republikes qe ka te beje me faturen financiare, Komisioni bazuar ne shkresen zyrtare te Zevendes kryeministrit ne te cilen ai shprehej se ligji nuk ka fature financiare, ishte i mendimit se ligji i miratuar ne Kuvend nuk ka shpenzime per buxhetin e shtetit.
2. Lidhur me ceshtjen e ngritur ne dekret per situaten konfliktuale qe krijohet me ligjin "Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Ministrave" persa i perket krijimit te Komitetit Nderministror, Komisioni ishte i mendimit se ligji "Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Ministrave" ben rregullimin e pergjithshem te komiteteve nderministrore, por Kuvendit nuk mund t'i hiqej e drejta qe me ligj te posacem te vendoste krijimin e komiteteve me natyre te tille persa kohe keto dy struktura jane te vecanta dhe kryejne funksione te ndryshme.
3. Lidhur me nenin 11 te ligjit, per te cilin Presidenti i Republikes mendon se permban formulim antikushtetues me arsyetimin se zgjeron fushen e kompetences kushtetuese te percaktuar per Avokatin e Popullit, komisioni ishte i mendimit se ne te s'ka elemente antikushtetues pasi mbeshtetur ne ligjin organik per funksionimin e institucionit te Avokatit te Popullit, ketij institucioni i krijohet mundesia te ushtroje kompetenca te tjera te percaktuara me ligj te vecante sic eshte rasti edhe i ligjit "Per nje shoqeri gjinore te barabarte".

Mendimi i anetareve te Komisionit ne pakice per kete nen ishte se aryetimi i Presidentit te Republikes per kete ceshtje duhej te pranohej dhe per pasoje pika 3 nenit 11 te ligjit "Per nje shoqeri gjinore te barabarte" duhej te hiqej.

**Ne perfundim te shqyrtimit te dekretit, Komisioni mbeshtetur ne argumentat e paraqitura me siper, vendosi t'i propozoje seances plenare mospranimin e dekretit te Presidentit te Republikes per shqyrtimin edhe nje here ne Kuvend te ligjit "Per nje shoqeri gjinore te barabarte" persa i perket pikave 1 dhe 2, ndersa ne lidhje me nenin 11 pika 3 mendimi i pakices ne Komision ishte qe ky nen te hiqej fare.**

**Spartak BRAHO**

**KRYETAR**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

*Komisioni i Punës dhe i Çështjeve Sociale*

**RELACION**

**Për Dekretin nr. 4181, datë 23.3.2004 të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr. 9198, datë 26.2.2004 “Për një shoqëri gjinore të barabartë”**

Komisioni i Punës dhe i Çështjeve Sociale në mbledhjet e tij të datave 31 Mars dhe 5 Prill 2004 diskutoi dhe shqyrtoi Dekretin nr. 4181, datë 23.3.2004 të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr. 9198, datë 26.2.2004 “Për një shoqëri gjinore të barabartë”.

Komisioni diskutoi me hollësi, në prani edhe të specialistëve të ftuar të fushës argumentat e paraqitura në arsyetimin e dekretit të Presidentit të Republikës. Pas diskutimit dhe debatit të detajuar të të gjitha argumenteve të parashtruara, Komisioni me shumicë vlerëson se argumentat e paraqitura në dekretin e Presidentit janë të diskutueshme dhe nuk i gjen të mirëbazuara në formulimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Komisioni me shumicë vlerëson se problemet e terminologjisë së përdorur në ligjin e kthyer janë një problem tjetër që duhet vlerësuar nga Komisioni i Ligjeve dhe i Çështjeve Kushtetuese për përputhshmërinë e tyre me kuadrin ligjor ekzistues.

Komisioni me shumicën e votave të anëtarëve pjesëmarrës u shpreh kundër dekretit të Presidentit të Republikës. Nga anëtarë të veçantë u shpreh një votë kundër dhe dy abstenim ndaj qëndrimit të Komisionit.

**KRYETARI**  
  
**Elmaz SHERIFI**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KUVENDI**

*Komisioni i Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjeve*

**RELACION**

**Per dekretin e Presidentit te Republikes nr. 4181, date 23.03.2004  
“Per kthimin e ligjit nr. 9198, date 26.02.2004  
“Per nje shoqeri gjinore te barabarte”**

Komisioni i Ceshtjeve Kushtetuese dhe Ligjeve, ne mbledhjen e dates 29.06.2004 mori serish ne shqyrtim dekretin e Presidentit “Per kthimin e ligjit “Per nje shoqeri gjinore te barabarte”, pas kthimit nga seanca plenare per rishqyrtim edhe nje here ne komisione dhe reflektimin e verejtjeve te bera nga Presidenti i Republikes si dhe komenteve te detajuara te bera nga OSBE-ja.

1. U ra dakort qe titulli i ligjit nr. 9198, date 26.2.2004 te behet: ***“Per barazine gjinore ne shoqeri”***
2. Komisioni u shpreh dakort per te reflektuar mbi verejtjen e Presidentit per nenin 11 te ligjit, per te cilin Presidenti i Republikes mendon se permban formulim antikushtetues me arsyetimin se zgjeron fushen e kompetences kushtetuese te percaktuar per Avokatin e Popullit.

***Anetaret e Komisionit u shprehen qe pika 3 nenit 11 te ligjit “Per nje shoqeri gjinore te barabarte” te hiqet.***

3. Lidhur me ceshtjen e ngritur ne dekret per situaten konfliktuale qe krijohet me ligjin “Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Ministrave” persa i perket krijimit te Komitetit Nderministror, Komisioni u shpreh se ligji “Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Ministrave” ben rregullimin e pergjithshem te komiteteve nderministrore.

*Per kete arsye u ra dakort qe neni 12 te riformulohet ne kete menyre:*

"1. Per te realizuar politiken per barazi gjinore, per hartimin e promovimin e programeve dhe monitorimin e situates konkrete per ceshtjet gjinore, me urdher te Kryeministrit krijohet Komiteti Nderministror si organ keshillimor".

2. Perberja e ketij Komiteti, organizimi dhe funksionimi i tij, percaktohet ne urdhrin e Kryeministrit."

*4. Per rrjedhim te ketij riformulimi, neni 13 te hiqet.*

**Spartak BRAHO**

**KRYETAR**

